

Eshrefedin (Rexhep) Kastrati

(24.11.1979, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, elektrikist, pjesëtar i UÇK-së)

Mizahiri e kishte të mbaruar shkollën e lartë elektroteknike në Zvečan/Zvečan. Ishte veprimtar i Lëvizjes Popullore për Çlirimin e Kosovës. Në vitin 1997, ka marr pjesë në aksionin e mbledhjes së armatimeve për UÇK-në. Uniformën ushtarake e veshi në muajin prill të vitit 1998. Eshrefedini jetonte në fshatin Drenoc/Drenovac, së bashku me prindërit dhe pesë vëllezër dhe motra. Aderoi në shtabin lokal të UÇK-së më 26.04.1998, së bashku me vëllezërit Besnikun dhe Xhemën. Në muajin maj të vitit 1998, Bekimi u bë anëtar i shtabit të UÇK-së në *Carevec/Carevac*. Ariani u bë anëtar i UÇK-së në muajin maj të vitit 1998.

Që nga data 17.07.1998, Mizahiri, Esrefedini, Bekimi dhe Ariani kanë marrë pjesë në aksionin e çlirimit të **Rahovecit/Orahovac**. Në datën **21.07.1998**, njësi i tyre ishte i dislokuar në pozicionet mbi majën e *Vran Stenës*. Rreth orës 17:00, që të katër u plagosën rëndë nga eksplozimi i bombave, të cilat nga distanca prej 50 metrash i hodhën pjesëtarë të Brigadës së 549 të Motorizuar të UJ-së. Një kohë të gjatë nuk dihej asgjë për fatin e tyre. Pas përfundimit të luftës, disa pjesëtarë të UÇK-së shkuan deri te *Vran Stena*, ku i gjetën mbetjet e karbonizuara të katër burrave. Mbjetet mortore të Mizahirit, Esrefedinit, Bekimit dhe Arianit u varrosën në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac, në muajin qershor të vitit 1999.

Burimet: deklarata F.I, FDH-36752; SHFDUÇK, *Feniksët...6*, 209-213; SHFDUÇK, *Feniksët...12*, 66-69; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Bajram (Hysen) Veliu

(20.6.1967, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, pjesëtar i UÇK-së)

Bajrami aderoi në UÇK në muajin maj të vitit 1998. Ka rënë më **21.07.1998**, në betejë me pjesëtarë të policisë serbe te vendi i quajtur *Varri i Hamzës/Hamzin grob*, që gjendet përmbi varrezat serbe [**Orahovac/Rahovec**]. Bashkëlufëtaret e kanë varrosur

afër vendit të vrasjes, në fushën e quajtur *Bllato*. Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të Bajramit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës [varrezat myslimane] në Rahovec/Orahovac.

Burimet: SHFDUÇK, *Feniksët...10*, 50-52; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Hidaj (Hazër) Popaj

(16.6.1944, shqiptar nga Bellacërka/Bela Crkva, komuna e Rahovecit/Orahovac, tregtar, tre fëmijë)

Hidaj Popaj jetonte dhe punonte në Bellacërkë/Bela Crkva. Ishte pronar e një shitoreje. E kanë ndaluar në burgun e **Drenocit/Drenovac** më 7.06.1998. Herën e fundit e shihnin të gjallë rreth datës **21.07.1998**, në burgun e UÇK-së në **Malishevë/Mališevo**. Për fatin e tij nuk dihej asgjë për një kohë të gjatë. Në datën 24.05.2000, mbetjet e tij mortore janë gjetur në varrezat e Prishtinës/Priştina. Pas identifikimit më 5.12.2006, Hidajn e kanë varrosur në varrezat e Bellacërkës/Bela Crkva.

Gjykata Supreme e Kosovës e ka nxjerrë aktgjykimin e fuqiptotë në muajin prill të vitit 2009, me të cilën pjesëtarët e policisë ushtarake Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj dhe Agron Krasniqi u dënuan me burgim shumëvjeçar për shkak të ndalimit të paligjshëm dhe trajtimit çnjerëzor të Hidaj Popajt dhe të burgosurve të tjerë, në burgun e UÇK-së në Drenoc/Drenovac.

Burimet: OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297; FDH, *Rahovec...*, 2, FDH-5698; FDH, *Konflikt...*, xx, FDH-20032; Gjykata e Qarkut Prizren, K. num. 85/2005 (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.08.2006, FDH-33923; Gjykata Supreme e Kosovës, K.Z. 371/2008, (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.04.2009, FDH-29712.

Muhedin (Jonuz) Shehu

(19.03.1920, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, prijës fetar)

Hasan (Mustafë) Kafexhiu

(19.05.1931, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, gardian dhe shërbyes në Teqenë e Qytetit, dy fëmijë)

Sheh Muhedini ka gëzuar respekt të madh